



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 27    Datë 10.04.2017

**“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË REZERVËS UJORE PËR ENERGJI  
ELEKTRIKE”- SUBJEKTIT “DONI” Sh.p.k**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pika 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”,të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni” , me propozim të A.B.U Drin- Bunë , miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore , pas shqyrtimit te dokumentacionit perkates , Keshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

**Vendosi:**

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit **“DONI” Sh.p.k** me administrator **Z. Ramiz ALIAJ** , për përdorim të rezervës ujore , perroit te Skatines, degë e **Lumit Drin** , për prodhim energjie elektrike në fshatin Zogaj ,Njësia Administrative **Bytyç , Bashkia Tropoje , Qarku Kukës** . Sipas studimit të paraqitur nga subjekti , objekti **HEC OPLAZI** do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes Nr1: X1 – 44 42 239 ; Y1 – 46 84 428 ; Z1 – + 488 m

Koordinatat e veprës së marrjes Nr2: X1 – 44 40 589 ; Y1 – 46 83 208 ; Z1 – + 488 m

Koordinatat e godinës së centralit: X – 44 40 742 ; Y – 46 82 459 ; Z – + 445 m

Koordinatat e pikes së shkarkimit : X – 44 40 742 ; Y – 46 82 459 ; Z – + 445 m

Prurja mesatare e përroit: Q1mes= 0.940 m<sup>3</sup>/sek; Q2mes= 0.190 m<sup>3</sup>/sek;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 1.97 m<sup>3</sup>/sek;

Prurja ekologjike: Q ekol= 0.16 m<sup>3</sup>/sek;

Prurja që shkarkohet: Q= 1.97 m<sup>3</sup>/sek.

2- Autorizimi i përdorimit të rezerves ujore për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

**SEKRETARI**

**Martin PLLUMBI**



**KRYETARI**

**Paulin RADOVANI**